

إعداد خطيب ماهر

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderojmë, Atij ndihmë e falje i kërkojmë dhe tek Ai mbështetemi të na mbrojë nga ligësitë e veteve tona dhe nga veprat tona të këqija. Atë që Allahu e udhëzon, askush nuk e devijon, e atë që Ai e lë në humbje, askush nuk e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka zot që meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut, të Vetmit, pa shok, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij. Lëvdatat dhe bekimet e shumta të Allahut qofshin mbi të, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që i pasojnë me mirësi.

Sakaq, sheriatit është shpallur si një sistem që plotëson nevojat e njerëzve për një jetë të rregullt, pjesë e së cilës janë dhe rregullat që lidhen me hytben e xhumasë. Prandaj, përgjegjësia e hatibit është një përgjegjësi e madhe, dhe për këtë shkak e pamë të rëndësishme të përgatisim një libër me titull: (Përmbledhje e dobishme rreth dispozitave të muezinit, imamit, hatibit dhe xhamive)¹, si dhe përkthimin e tij në disa gjuhë. Ai përfshin disa tema, ndër të cilat janë:

Namazi i xhumasë, kuptimi, koha dhe disa nga dispozitat e namazit të xhumasë që lidhen me mukel-lefin (njeri i moshës madhore), si dhe hutbja

¹ - <https://islamcontent.com/ar/single-content/74839>.

e xhumasë, dispozitat, kushtet, shtyllat, sunetet dhe çështja e përkthimit të saj, përfshi këtu edhe cilësitë shkencore e morale që duhet t'i ketë ligjëruesi, etikën e hutbes dhe ligjëruesit, qëllimin e hutbes dhe objektivat e saj, si dhe mënyrën e përgatitjes së saj.

Meqenëse tema ishte me rëndësi të madhe, erdhi kjo broshurë e dytë me titull (Përgatitja e hatibit të aftë), si zgjerim dhe plotësim i librit të mëparshëm.

I lutemi Allahut që punën tonë ta bëjë të mirë e të sinqertë për hir të Tij, dhe ta bekojë atë. Allahu është më i dijsmi; paqja dhe bekimet e Tij qofshin për pejgamberin tonë, Muhamedin.

RËNDËSIA E HUTBES

Minberi i xhumasë: është prej mjeteve më të fuqishme – madje më i fuqishmi – për të ndikuar te njerëzit, nëse shfrytëzohet siç duhet, sepse ligjëruesi u flet njerëzve një herë në javë përgjatë viteve të tëra, qofshin ato të pakta apo të shumta, e ata e dëgjojnë atë me mendje të hapura dhe zemra të gjëra. Kështu, ata nuk shpërqendrohen nga ligjërata e tij dhe nuk prekin as guralecët, dhe marrin prej tij këshillat, porositë, mësimet dhe urtësitë në mënyrë të përsëritur e të vazhdueshme.

Ligjëruesi i suksesshëm, të cilit Allahu i ka dhuruar stil bindës dhe elokuencë të fuqishme, pa dyshim që do të ketë një ndikim të thellë tek ata. Madje, ndikimi i tij mund të jetë më i fortë sesa ai i

mësuesit tek nxënësit e tij dhe më i fuqishëm sesa ndikimi i rrjeteve sociale. Kjo sepse hutbja është e lidhur me një adhurim madhështor, që është namazi. Gjithashtu, sepse ligjëruesi elokuent, dashamirës dhe orator u drejtohet njerëzve drejtpërdrejt, duke qëndruar para tyre. Ata shohin shprehjet e fytyrës dhe vështrimin e syve të tij, kështu ai ndikon tek ata përmes shqisës së të dëgjuarit dhe të parit, duke prekur zemrat dhe mendjet e tyre. Ata e dëgjojnë me vëmendje gjatë gjithë hutbes së tij, ndërkohë që ai u paraqet argumente dhe prova racionale e tekstuale, me anë të të cilave – me lejen e Allahut – arrin t'i bindë dhe t'ua korrigjojë konceptet e tyre.

Ligjëruesi i suksesshëm dhe i udhëzuar është ai që e ka bërë minberin një nga dyert më të rëndësishme për përhapjen e së mirës dhe të diturisë, por që nuk mjaftohet vetëm me kaq; përkundrazi, ai merr pjesë dhe kontribuon në çdo fushë të së mirës dhe bamirësisë, sipas mundësive të tij. Kudo që gjendet e mira, e gjen atë aty si një ndër pararojat e saj, dhe kudo që kërkohet sakrificë për hir të Allahut, e gjen atë aty si njërin prej ushtarëve të Tij.

Pra, ky ligjërues është ai që kujdeset për predikimin e fesë së Allahut dhe për dobinë e muslimanëve – siç ishin pejgamberët dhe të dërguarit, dijetarët dhe predikuesit e sinqertë të umetit islam – i zellshëm në ripërtëritjen,

motivimin dhe ngjalljen e interesit tek dëgjuesit e tij.

Ka shumë ligjërues që i plotësojnë cilësitë e ligjëruesit, por hutbja e tyre nuk e jep frytin e dëshiruar, ashtu siç kërkohet nga ligjëruesi që e bart mesazhin me sinqeritet dhe përkushtim.

Në çdo xhuma u sjell një temë që prek ndjenjat dhe nevojat e tyre dhe ua rrëmben zemrat. Ai takohet me ta mbi pesëdhjetë herë gjatë një viti. A ka, pra, ndonjë mjet me ndikim më të fuqishëm se ky?

Prandaj s'ka dyshim se hutbja e xhumasë është prej simboleve më madhore të Islamit dhe një nga fushat më të rëndësishme të thirrjes për tek Allahu, të përhapjes së Sheriatit të Tij dhe të sqarimit të argumentit ndaj robërve të Tij. Ajo është diçka të cilën edhe armiq të Islamit dëshirojnë ta kishin në fenë e tyre, saqë njëri prej udhëheqësve të partive që luftojnë Islamin ka thënë: "Ah, sikur të kisha dhe unë podiume si këto (të muslimanëve)?!"

Shkencat dhe profesionet janë po aq fisnike sa janë objektivat e tyre. Sakaq ligjërimi i xhumasë ka një objektiv të rëndësishëm, që është: udhëzimi i njerëzve drejt të vërtetave dhe motivimi i tyre për t'u angazhuar me gjëra që u sjellin dobi në këtë jetë dhe në jetën e përtejme.

Ligjërimi konsiderohet si një nga mjetet e sundimit dhe udhëheqjes.

Pra, ligjërimi është nder i madh, dhe nderi i tij qëndron në faktin që personi që e praktikon atë duhet të jetë i mprehtë, i ditur dhe elokuent.(2)¹

Ligjvënësi e ka bërë detyrë për namazliun që të të dëgjojë në heshtje ty – o vëlla ligjërues – gjatë ligjërimit tënd. Profeti (paqja qoftë mbi të) ka thënë:

«إِذَا قُلْتَ لِصَاحِبِكَ يَوْمَ الْجُمُعَةِ أَنْصِتْ، وَالْإِمَامُ يَخْطُبُ، فَقَدْ لَعُوتَ».

"Nëse në ditën e premte, teksa imami është duke ligjëruar, i thua shokut tënd "Hesht!", ke bërë një veprim të kotë." E shënojnë Buhariu dhe Muslimi. (3)² Domethënë, nuk e fiton shpërblimin e xhumasë.

Madje, është pjesë e etikës që njerëzit t'i kthejnë fytyrat e tyre nga ti. Neveviu, Ibën Mundhiri dhe Ibën Abdulberri – Allahu i mëshiroftë – kanë transmetuar konsensusin e dijetarëve se kthimi i fytyrës nga hatibi në kohën që ligjëron është veprim i pëlqyeshëm.³

Melekët e Mëshiruesit të dëgjojnë me vëmendje, prandaj jepu pozitën që u takon!

Të mjafton si nder dhe krenari – o ligjërues i xhumasë – që melekët e Rrahmanit marrin pjesë për të dëgjuar me vëmendje ligjëratat dhe këshillat e tua. I Dërguari i Allahut – paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të – ka thënë, siç transmetohet

¹ - "Ligjërimi tek arabët", i Muhamed El-Hidr Husejn: fq.178-179.

² Transmetuan Buhariu nr. 934 dhe Muslimi nr. 851.

³ - "El Mexhmu", 4/ 447.

në dy Sahihët: "Ditën e xhuma, në çdo derë të xhamisë qëndrojnë melekët dhe i shënojnë ata që vijnë sipas radhës. Kur imami ulet, ata i palosin fletët dhe vijnë për të dëgjuar këshillën."

Nëse je i vetëdijsëm për këtë, atëherë pozita e hutbes do të zërë vend të rëndësishëm në zemrën tënde dhe do të të shtohet zelli për thënien e së vërtetës, përmbushjen e përgjegjesisë, këshillimin e njerëzve, pa synuar pëlqimin e tyre dhe pa u bërë lajka.

E kush është si ti, o ligjërues i nderuar!?

Allahu ia ka bërë detyrë njerëzve që të dëgjojnë ty dhe të jenë të vëmendshëm ndaj fjalës tënde, madje ia ka ndaluar atyre të shpërqendrohen, qoftë edhe me lëvizjen e guralecëve apo diçkaje të ngjashme dhe të kundërshtojnë të keqen gjatë fjalimit tënd, dhe ka bërë që melekët e Tij të të dëgjojnë me vëmendje.

Kjo gjë e bën të detyrueshme për ty që të jesh i sinqertë për Allahun dhe që këshillat dhe ligjëratat e tua ndaj njerëzve të jenë sa më dashamirëse, dhe që qëllimi i ligjëratave të tua të jetë përmendja e Allahut, këshillimi i njerëzve, ndërgjegjësimi i tyre në lidhje me çështjet e fesë dhe në lidhje me gjërat që ua përmirësojnë atyre jetën e kësaj bote.

¹ Transmetuan Buhariu nr. 3211 dhe Muslimi nr. 850.

Cila është më e mirë: improvizimi i ligjëratës apo leximi i saj nga letra?

Pa dyshim se leximi i ligjëratës nga letra ka dobi të shumta dhe për shumë ligjërues e folës kjo mund të jetë më e përshtatshme sesa improvizimi. Kjo është një çështje e dëshmuar dhe reale.

Improvizimi ka ndikim të madh në motivimin dhe entuziazmin e ligjëruesit, dhe kjo, pa dyshim, bën që dëgjuesit të preken, entuziazmohen dhe të motivohen, dhe anasjelltas.

Dihet se kur në marrjen e informacionit marrin pjesë bashkërisht shqisa e dëgjimit dhe e shikimit, kjo bën që përvetësimi i informacionit të jetë më i fuqishëm, ndikimi të jetë më i madh dhe ngulitja e informacionit të jetë më e qëndrueshme. Ndryshe nga rasti kur përdoret vetëm njëra prej tyre. Prandaj, ligjëruesi që ligjëron pa letër dhe u drejtohet njerëzve ballë për ballë dhe komunikon me ta me sy, ka ndikim më të madh sesa ai që ligjëron duke lexuar, nga i cili njerëzit marrin informacion vetëm përmes dëgjimit. Madje, edhe ky perceptim nuk e ka atë fuqi si në rastin e ligjëruesit që flet pa letër, pasi zëri i tij është më i fuqishëm dhe më ndikues.

Ai që e ka provuar improvizimin disa herë dhe gjatë tij ka hezituuar, është ngatërruar dhe ka harruar shumë herë, apo ka pasur frikë e tension të madh, dhe e sheh se kjo gjendje nuk përmirësohet

me kalimin e kohës dhe me praktikimin e shpeshtë, atëherë le t'i mbajë me letër ligjëratat, sepse jo çdokush është i suksesshëm në improvizim. Allahu, ashtu siç ka ndarë mes njerëzve furnizimet materiale, ka ndarë mes tyre edhe furnizimet shpirtërore, si: moralin, aftësitë, talentet dhe aspiratat e larta.

TETË HAPA QË LEHTËSOJNË DHE HAPIN RRUGËN DREJT PERFORMANCËS SË SUKSESSHME NË LIGJËRIM

E para: Lutja dhe përgjërimi i sinqertë ndaj Allahut të Madhëruar që Ai të të ndihmojë në këtë drejtim.

Së dyti: Mbështetja e sinqertë dhe e rregullt në Allahun e Lartësuar. Allahu është ashtu siç mendon robi i Tij për Të, e kushdo që i mbështetet Atij, Ai i mjafton për çdo gjë që e preokupon dhe që e kërkon.

E treta: Dëgjimi i ligjëruesve të dalluar dhe përfitimi nga përvojat e tyre.

Së katërti: Ligjërimi i hutbes veçmas; e nëse e bën këtë në xhami përmes altoparlantit të brendshëm, është më mirë, e nëse e bën në minber (podium), është edhe më mirë.

Së pesti: Edukimi dhe kalitja e vetes në shfaqjen e ndjenjave dhe forcimin e emocioneve.

Pasi kam medituar rreth sekreteve më të mëdha të ligjëruesve dhe oratorëve të suksesshëm e me ndikim, kam zbuluar se sekreti dhe shkaku i kësaj – pas suksesit të dhënë nga Allahu – janë ndjenjat e forta që ata zotërojnë, aftësia e tyre për t'i shfaqur ndjenjat e tyre me hollësi e jo në mënyrë të përgjithshme, dhe gjithnjë në përputhje me rregullat sheriatike.

Sepse ndjenjat e forta e shtyjnë oratorin ta tregojë oratorinë që zotëron dhe të urtin e shtyjnë të shpalosë urtësitë që gëzon, kështu ai që zotëron ndjenja të forta i bën zemrat për vete me magjinë e ndjenjave dhe i pushton mendjet me bukurinë e mjeshtërinë e tyre. Kurse ai që ka ndjenja të dobëta, me vdekjen e ndjenjave i vdes edhe një pjesë e madhe e dijes, e kështu shuhet edhe ndikimi i tij tek njerëzit.

Prandaj, ligjëruesi (hatibi) duhet që të jetë plot entuziazëm në predikimin e tij dhe të jetë i bindur në vërtetësinë e asaj që thotë, sepse ajo që del nga zemra, hyn në zemër. Entuziazmi i ligjëruesit duhet të jetë patjetër më i fortë se ai i dëgjuesve të tij, që të depërtojë tek ata dhe t'ua shuajë ëndjen. Përndryshe, ata do të ndiejnë plogështi nga ana e tij dhe kështu ndikimi i fjalës së tij do të venitet.

Duhet medoemos të ushtrohet në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet shkrimit të mendimeve dhe ndjenjave, artikulimit të tyre në vetmi, e më pas, shprehjes së tyre para një dashamirësi.

Ndjenjat, sa herë që ndrydhen e frenohen, thahen e shterojnë. E sa herë që lihen të lira – me kusht që të jenë brenda kornizave sheriatike – ato shpërthejnë e vërshojnë, e kështu ujisin fletët me shkrime e përpilime, minberët me ligjërata e fjalime dhe njerëzit me dashuri e butësi.

Prandaj – vëllai im ligjërues – lëri të lira ndjenjat dhe emocionet e tua, që të gjallërohet te ti dhe te të tjerët shpirti i jetës, i krijimtarisë, i rilindjes, i zhvillimit dhe i mëshirës.

Atij që i fisnikërohen ndjenjat, i lartësohet morali, i fisnikërohet shpirti, i shtohen miqtë dhe i pakësohen armiqtë, i triumfon argumenti, i forcohet elokuenca dhe i shtohet oratoria.

Së gjashti: Të kërkojë këshillë nga një njeri i sinqertë, i mençur, me përvojë dhe dashamirës, i cili i vë në dukje të metat që t'i shmangë dhe vlerat që t'i përvetësojë e t'i shtojë.

E shtata: Përgatitja e hershme e hutbes (ligjëratës).

Së teti: Leximi i librave që kanë të bëjnë me përgatitjen e hutbes dhe mënyrën e ligjërimit.¹

¹ - Shih: "Broshurë e dobishme rreth dispozitave të muezinit, imamit, hatibit dhe xhamive", fq. 95, <https://islamcontent.com/ar/single-content/74839>.

ANKTHI DHE TENSIONI NË FILLIM TË MBAJTJES SË HUTBEVE ËSHTË DIÇKA NORMALE DHE E ZAKONSHME

Në fillim të mbajtjes së hutbeve, do të ndjesh ankth dhe frikë, dhe kjo është pjesë e natyrës njerëzore. Mund të të duket se kjo është pasojë e vështirimit të njerëzve drejt teje dhe e mendimit tënd për mangësitë e tua në dije.

Po ashtu, ankthin tënd mund ta shtojë ndjenja se njerëzit e vërejnë këtë dhe e urrejnë që të jetë te ligjëruesi, dhe ndoshta kjo bëhet shkak që ata të largohen prej teje.

Pa dyshim se me lidhjen tënde të fortë me Allahun, mbështetjen te Ai, lutjen e sinqertë dhe me praktikë të vazhdueshme, frika do të zhduket plotësisht, derisa të arrish në fazën kur ndjen kënaqësi nga hutbja dhe e pret me padurim ditën e xhumasë për të shijuar ëmbëlsinë e ligjërimit.

Pra, vetëm me durim i hapen njeriut thesaret e suksesit dhe mirësitë e Bujarit dhe Dhuruesit të Lartësuar.

Prandaj, të durosh mundin dhe vështirësinë në fillim, do të thotë të arrish begati, pozitë të lartë dhe lumturi, në fund.

Dhe thuaj vetes: pas vështirësisë vjen lehtësimi dhe largimi i brengës, e pas lodhjes vjen rehatia. Bëhet fjalë për durim të një çasti të vetëm, prandaj duro dhe qëndro i durueshëm, që të ngrihesh lart

në minbere dhe ta kumtosh hapur thirrjen për tek Allahu. Të vërtetën e ka thënë Allahu, e kush është më drejtë se Allahu në fjalë?:

(وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا)

"Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona." (El Ankebut, 69)

Sa bukur e ka thënë Katadja (Allahu e pastë mëshiruar!): "O biri i Ademit, nëse ti nuk dëshiron të bësh vepra të mira përveçse kur ke zell, atëherë nefsi yt anon nga mërzia, plogështia dhe dembelizmi. Mirëpo, besimtari i vërtetë e detyron veten, e forcon dhe e disiplinon atë."¹ Me 'e disiplinon atë.' (ar. mutesheddîd) nënkuptohet ai që ia obligon vetes vazhdimësinë në kryerjen e veprave të mira.

SHKAQET E KAPËRCIMIT TË FRIKËS SË TEPRUAR NGA TË FOLURIT NË PUBLIK

Frika, veçanërisht në fillim, është diçka tejet e zakonshme dhe normale, siç u tha dhe më sipër. Në fakt, ajo është pozitive, sepse ndihmon në përkujdesjen për hytben dhe në përgatitjen e saj. Ajo e frenon egon nga vetëbesimi i tepruar, i cili çon në nënçmimin e njerëzve, në mosinteresimin ndaj

¹ - "Tefsiri i Kurtubiut", 1/251. Ndërsa fjalën e Katades (Allahu e pastë mëshiruar!), e shënon Ebul-Kasim Ibn Bushran El-Bagdadi (vdiq më 430 h.), në "Emaliye", nr. 1454.

cilësisë së materialit, si dhe në mospërzgjedhjen e fjalëve dhe kuptimeve të duhura.

Mirëpo, frika e vazhdueshme në çdo hutbe dhe për një kohë të gjatë është negative, në kohën e sotme ajo njihet si fobia sociale, duhet të merren masat për t'u çliruar prej saj, e disa nga këto masa janë:

Së pari: Singeriteti ndaj Allahut të Madhëruar, mbështetja tek Ai dhe lutja e shpeshtë që të të dhurojë qetësi dhe ta mbushë zemrën tënde me prehje.

E dyta: Pirja e pijeve qetësuese para hutbes, si nenexhiku etj., sepse ato kanë ndikim në qetësimin e ankthit dhe të frikës.

Së treti: Përgatitja e vetes për pranimin e kritikës dhe mirëpritjes së saj; kjo shërben si mjet për të përparuar dhe për të qenë më krijues, si dhe për të shpëtuar nga frika prej gabimeve.

Së katërti: Vajtja herët në xhami, sepse sigurisht ligjëruesi që vjen në xhami i nxituar, në momentin e fundit, është i trazuar, i shqetësuar dhe në ankth e tension, dhe kjo situatë mbase e shoqëron atë gjatë gjithë hutbes.

Së pesti: Ngrije kokën që t'i shikosh njerëzit dhe herë pas here fol në mënyrë spontane. Edhe nëse në fillim has vështirësi, gabime e hezitime, por ta dish se përqëndrimi yt i vazhdueshëm vetëm te shkrimi në letër dhe mosshikimi i dëgjuesve me guxim ua largon atyre entuziazmin që duhet të kenë për

ligjërimin tënd dhe bën që ti të vazhdosh të kesh frikë e drojë nga minberi.

Disa ligjërues, të cilët kanë vite që ligjërojnë, por që nuk i shkëputen letrës dhe nuk e shikojnë publikun, kanë pohuar se ndiejnë frikë dhe ankth në çdo hutbe. Madje, njëri prej tyre thotë: “Unë, në çdo hutbe, ndihem sikur po ligjëroj për herë të parë, nga shqetësimi dhe droja!”

Por, në fillim të hutbeve të tua mos i shiko fytyrat e njerëzve, pasi mund të të zërë syri dikë që i druhash e të hutohesh, dhe mund të të frikësojë shikimi i njerëzve drejt teje. Përkundrazi, shiko kokat e tyre, pa u përqendruar te personat dhe sytë e tyre.

Së gjashti: Gjatë ngjytjes në minber mos mendo për pikat negative apo gabimet e mundshme, por mendo për pikat pozitive që shpreson t'i arrish, me lejen e Allahut, dhe për përfitimet e mëdha që do të realizosh përmes hutbes sate, si: dobia për njerëzit, mbarësia që Allahu të ka dhënë në zbatimin e parimit madhor të urdhërimit për mirë dhe ndalimit nga e keqja, dhe predikimi i fesë së Tij.

Së shtati: Ushtro frymëmarrjen e saktë para hutbes, duke marrë frymë thellë përmes hundës, pastaj duke e mbajtur ajrin për pak çaste dhe më pas duke e nxjerrë ngadalë. Kjo lloj frymëmarrjeje ka ndikim të madh në largimin e tensionit; ekspertët e fushës dhe të mjekësisë kanë përmendur se frymëmarrja e zakonshme pompon

shtatë deri në dhjetë litra oksigjen në tru, ndërsa në rastet e frymëmarrjes së saktë pompohen rreth shtatëdhjetë e pesë litra oksigjen. Kjo çon në uljen e niveleve të hormoneve të ankthit dhe stresit. Kjo gjë është provuar dhe është vërtetuar se ka ndikim të madh në largimin e tensionit, brengës dhe ankthit.

Ndërsa gjatë hutbes, përpiku të marrësh frymë thellë pa i rënë në sy të pranishmëve, duke marrë frymë shpejt e me sasi të madhe përmes gojës ose hundës gjatë ndalesave të përshtatshme. Më pas, pas kësaj frymëmarrjeje, vazhdo me ligjërimin. Vepro kështu pothuajse në çdo ndalesë.

ZGJIDHJA MË E MIRË PËR KRITIKAT E GABUARA QË TË VIJNË

Kur të jesh i bindur, o vëlla ligjërues, për një vendim që ke marrë, një stil që ke pëlqyer apo një metodë që ke ndjekur, pasi e ke menduar e medituuar thellë dhe je konsultuar me njerëz me përvojë, atëherë mos ua vër veshin kritikuesve dhe qortuesve, sepse askush, sado lart të arrijë dhe çfarëdo që të bëjë, nuk u shpëton dot kritikave të njerëzve.

Nëse i kushton vëmendje kritikës së tyre: të dobësohet vullneti, të ngushtohet gjoksi, dhe të venitet dëshira për përparim e krijimtari.

Nuk ka libër, as shkrim e as vepër, veçse del dikush që e kritikon dhe pretendon se i ka gjetur të meta.

Sillu me kritikuesit me butësi dhe respekt, ktheju përgjigje në mënyrën më të mirë dhe pranoje të vërtetën që ata kanë. Mos e përbuz këtë, edhe nëse ai që të kritikon nuk ka ndonjë rëndësi për ty.

POROSI PËR LIGJËRUESIN PARA HUTBES

Vëllai im ligjërues, është e rëndësishme që para hutbes të bësh disa gjëra, që do të ndihmojnë ty, pas Allahut të Madhërishëm, për të qëndruar në minber dhe për të mbajtur hutbet e tua. Disa nga këto gjëra janë:

1- Të jesh i vetëdijshëm se ti po shkon të kumtosh mesazhin e Allahut dhe të ftosh njerëzit tek Ai, andaj lexo – nganjëherë – fjalën e Tij:

﴿الَّذِينَ يُبَلِّغُونَ رِسَالَاتِ اللَّهِ وَيَخْشَوْنَهُ وَلَا يَخْشَوْنَ أَحَدًا إِلَّا اللَّهَ﴾

"Ata të cilët kumtojnë mesazhin e Allahut dhe i druhen Atij e askujt tjetër përveç Tij." Dhe nganjëherë lexo fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿وَمَنْ أَحْسَنُ قَوْلًا مِّمَّنْ دَعَا إِلَى اللَّهِ وَعَمِلَ صَالِحًا وَقَالَ إِنَّنِي مِنَ الْمُسْلِمِينَ﴾

"E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: 'Unë, me të vërtetë jam musliman.'" (Fusilet, 33)

Dhe fjalën e Tij:

﴿قُلْ هَذِهِ سَبِيلِي أَدْعُو إِلَى اللَّهِ عَلَى بَصِيرَةٍ أَنَا وَمَنِ اتَّبَعَنِي وَسُبْحَانَ اللَّهِ وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ﴾

"Thuaj: 'Kjo është rruga ime: të ftoj drejt Allahut me dituri të plotë, unë dhe çdokush që më pason mua. I përlëvduar qoftë Allahu; unë nuk jam prej idhujtarëve!'" (Jusuf, 108)

Sepse kjo të shtyn të jesh më i sinqertë, të kesh më shumë vullnet, ta pasosh më mirë Profetin (paqja qoftë mbi të!) dhe të jesh më i vetëdijshëm për qëllimin madhor të ligjërimit, për të cilin Allahu i Lartësuar dërgoi peygamberët dhe të dërguarit e Tij, e që është kumtimi i fesë dhe përhapja e saj. Dhe që konsiderohet si pozita më madhështore në këtë botë.

2- Lutju Allahut pak para se të ngjitesh në minber që të të dhurojë sinqeritet, sukses dhe drejtësi, dhe që fjalët e tua të jenë të dobishme për ty dhe për të tjerët. Sepse sa e sa ligjërues (hatibë) dhe folës nuk marrin mësim nga ajo që thonë, e edhe nëse marrin mësim, shumë shpejt e harrojnë atë që kanë thënë, sidomos nëse kalon një kohë e gjatë.

Dhe kërkoji Allahut të Lartësuar vazhdimisht që të të begatojë me elokuencë dhe qartësi në të shprehur.

3- Përgatitja e një sërë hutbesh, zakonisht shumë kohë para mbajtjes së tyre: disa muaj apo vite më herët.

Kur të vijë ndërmend një temë, ose has gjatë leximit diçka të vlefshme, një hadith që të tërheq vëmendjen, apo një ajet që të bën të meditosh: shënoje atë menjëherë, pa u vonuar, sa ndjenjat janë ende të ndezura dhe mendimet të freskëta e të ndërlydhura. E nëse e shtyn shënimin e tyre për më vonë, mendimet dhe idetë do të humbin dhe do të jetë e vështirë t'i kujtosh e t'i risilljellësh sërish

ndërmend. Pas kësaj shkruaj gjithashtu mendimet që të vijnë ndërmend. Më pas, fillo me mbledhjen e lëndës shkencore – pa u stresuar – nga Kurani, Suneti dhe nga fjalët e dijetarëve, fjalët e të cilëve i ke hasur gjatë leximit të librave të tyre apo librave që transmetojnë prej tyre. Gjithashtu hulumto në “Mektebetu Shamile” apo në rrjetin e internetit, sipas nevojës.

Kushtoji rëndësi të veçantë ajeteve kuranore dhe haditheve profetike, fjalëve të selefëve dhe trashëgimisë së tyre, historisë, dhe fjalëve të dijetarëve të devotshëm bashkëkohorë, sidomos në lidhje me çështjet bashkëkohore dhe ngjarjet e reja.

Nëse gjen diçka që lidhet me temën e hutbes: merre dhe vendose në një skedar (dosje) në kompjuter, pa renditje dhe redaktim.

Kështu vepro gjithmonë me çdo temë apo informacion të dobishëm që të shkon ndërmend ose të del përpara; shënoji menjëherë mendimet që të vijnë ndërmend, hulumto dhe shkruaj aq sa ke mundësi, pastaj lëre anash dhe vazhdo me leximin tënd të zakonshëm. Nëse gjen ndonjë informacion të dobishëm, ajet apo hadith që lidhet me njërën nga hutbet që i ke shkruar, atëherë shtoja atë asaj.

Mundet që një hutbe të mbetet tek ti për disa vite; mbaje atë në mësimet apo fjalimet e tua. Sepse në këtë mënyrë do të të vijnë ndërmend detaje dhe informacione të dobishme që nuk të kishin ardhur ndërmend më parë, do të kujtosh gjëra që i kishe

harruar dhe kështu hutbja do të jetë e gatshme dhe e kompletuar – brenda mundësisë – kur të dëshirosh ta mbash në hutben e xhumasë.

4- Mbaje atë të plotë ose të ndarë, në fjalimet e tua në xhami ose në mbledhjet private. Qëllimi i kësaj është:

a) Përforcimi i informacioneve dhe memorizimi i tyre.

b) Përhapja e tyre në mesin e njerëzve, veçanërisht në xhamitë që nuk janë pranë xhamisë ku ti mban hutben, pasi që zakonisht xhemati yt nuk është i pranishëm aty.

c) Zgjerimi dhe thellimi më tej i temës, meqenëse zakonisht kur e mban një ligjëratë, gjatë saj ose pas saj, do të të dalin në pah çështje të rëndësishme që duhen trajtuar, ose do të lindin pyetje dhe kërkesa për sqarim nga dëgjuesit.

5- Mbaje atë ditën e xhuma, përafërsisht dy orë para kohës së hutbes, sikurse do ta mbaje në hutbe.

6- Nuk duhet të stërmundoresh me kërkime dhe përgatitje të tepërta, por synimi yt të jetë mbledhja e një materiali që në radhë të parë të jetë i dobishëm për ty, e më pas për dëgjuesit të cilët i përkasin shtresave të ndryshme.

Kam parë se teprimi në çdo gjë është i dëmshëm e i mundimshëm, dhe zakonisht e çon njeriun drejt braktisjes (së veprës), ose drejt mërzhisë e plogështisë.

UDHËZIME PËR LIGJËRUESIN GJATË HUTBES

Janë disa çështje që duhet t'i zbatosh gjatë hutbes, si:

E para: Mos u sforco as për të sajuar ndjenja e as për t'i fshehur ato kur përjeton ngjarjet e tregimeve, situatat dhe mësimet, por, sipas kontekstit, shfaq ndjenjat e tua përmes tipareve të fytyrës, shprehjes së syve dhe ndryshimit të tonit të zërit.

Dije se sa më i natyrshëm dhe i pashtirur të jetë ligjërimi yt, aq më me ndikim do të jetë. Prandaj, qëndroji besnik natyrës tënde me të cilën je rritur dhe stilit që praktikon gjatë bisedave të zakonshme, jashtë hutbes, duke i kushtuar kujdes intonacionit të zërit dhe përmirësimit të performancës.

Shumë prej ligjëruesve përdorin për hutben një stil krejtësisht të ndryshëm nga stili i tyre i zakonshëm, sikur mendojnë se ligjërimi ka një stil të posaçëm dhe një model unik e të veçantë. Kjo gjë ua humbet atyre ndikimin tek dëgjuesit dhe depërtimin në zemrat e tyre.

Së dyti: Mos e mbaj hutben rrëmbimthi, e as mos nxito aq sa t'ia bësh të pamundur dëgjuesit dëgjimin e plotë të saj. Ligjëro me maturi, duke bërë pauza të shkurtra sipas nevojës. Kushtoji vëmendje intonacionit të zërit, sipas kontekstit të duhur.

Kështu, ngrije zërin dhe shpejtoje ligjërimin nëse rasti e kërkon një gjë të tillë.

Së treti: Llogarite me saktësi kohën e hutbes dhe mos e zgjat atë, përveçse kur është e nevojshme.

Së katërti: Kur sheh ndonjë shkelje që bëhet nga të pranishmit gjatë hutbes, tërhiqi vërejtjen me butësi; për shembull, nëse sheh dikë që flet gjatë hutbes, bëj një vërejtje të përgjithshme për këtë gabim.

POROSI PËR HATIBIN PAS HUTBES

Janë disa çështje që duhet t'i bësh pas hutbes, si:

E para: Falënderimi i Allahut të Lartësuar për suksesin që të dha në mbajtjen e hutbes.

Së dyti: T'i dëgjosh hutbet e tua pasi t'i kesh mbajtur, me qëllim që të evidentosh anët pozitive për t'i përforcuar e konsoliduar, si dhe anët negative për t'i shmangur e për t'u ruajtur prej tyre.

Dhe e gjithë kjo duhet bërë sepse:

Së pari: për të respektuar pozitën e hutbes, e cila ka vlerën dhe pozitën e saj në Islam.

Së dyti: për të respektuar namazlinjtë, të cilët kanë ardhur nga bindja që kanë ndaj Zotit të tyre, si përgjigje ndaj thirrjes së Krijuesit të tyre dhe nga dashuria për të dëgjuar atë që ti do t'u thuash.

Po ashtu, mund t'ia përcjellësh një dashamirësi të sinqertë, që të të orientojë mbi anët pozitive dhe negative që ajo përmban.

Gjithashtu, nëse është e mundur, ajo të regjistrohet dhe të shpërndahet, sidomos në vendet ku ka pak ligjërues, që të përfitojnë prej saj njerëzit e thjeshtë që nuk falen me ty, dhe të shpërndahet në formë audio dhe të shkruar.

Edhe sikur të krijohej për hutbet një faqe në rrjetet sociale, apo një faqe interneti e veçantë, kjo do të ishte diçka e mirë.

Gjithashtu, bashkëpunimi me faqet e internetit që publikojnë hutbet që të publikojnë dhe hutbet e tua në këto faqe, veçanërisht hutbet e përkthyer, për shkak se janë të pakta.

KËSHILLA TË PËRGJITHSHME PËR LIGJËRUESIN DHE PREDIKUESIN

Ty, o vëllai im, ligjërues i xhumasë, po t'i drejtojmë këto këshilla, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse një përkujtim për të gjithë ne:

1-Përgëzo dhe mos krijo panik!¹

Ligjëruesi i suksesshëm është ai që përgëzon dhe nuk krijon panik, mbjell te njerëzit frymën e optimizmit dhe të shpresës, largon pluhurin e dëshpërimit e të përtacisë dhe nxit për zell e punë.

Ki kujdes, o vëlla ligjërues, që temat e hutbeve të tua të mos sillen rreth tragjedi, fatkeqësive dhe aspekteve negative që mund të ndodhin në çdo

¹ - Hadithin e shënojnë Ebu Davudi (531), Ibn Maxheh (987), Imam Ahmedi (17906) dhe të tjerë, dhe e ka vlerësuar të saktë Albani.

kohë e vend. Përkundrazi, shumicën e hutbeve të tua kushtoja optimizmit dhe shembujve të ndritshëm në moral, sjellje dhe personaliteteve të larta, në mënyrë që njerëzit t'i marrin këto sjellje dhe këta njerëz si shembull dhe pishtar ndriçues në jetën e tyre.

E nëse vëren ndonjë gabim, atëherë nuk ka gjë të keqe të tërheqësh vërejtjen dhe t'i paralajmërosh njerëzit prej tij, në mënyrën fetare dhe me metodë të përshtatshme.

2-Ki në qendër të vëmendjes publikun e gjerë!¹

Ki në qendër të vëmendjes – Allahu të ruajtë – publikun e gjerë, sepse ata kanë më shumë të drejtë dhe përparësi për hutbet dhe këshillat e tua, sipas fjalës së Profetit (paqja qoftë mbi të!) drejtuar Uthman ibn Ebi el-Asit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), kur u emërua prijës i popullit të tij:

"وَأَقْتَدِ بِأُضْعَفِهِمْ".

"Ki parasysh më të dobët të tyre!"²

Domethënë, merre parasysh gjendjen e më të dobëtëve nga xhemati dhe fal një namaz që nuk i rëndon ata. Marrja parasysh e të dobëtëve në logjikë nuk është më pak e rëndësishme se marrja parasysh e të dobëtëve në shëndet!

¹ - "Shkallët e udhëtarëve ndërmjet vendqëndrimeve të 'Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë': (2/ 66).

² - "Sajdul Hatir", 67.

Por nëse kujdesesh për elitën dhe njerëzit e veçantë, si dhe për dashamirësit dhe nxënësit e tu, e i lë pas dore njerëzit e zakonshëm, atëherë kjo do të të çojë drejt disa pasojave të rrezikshme:

E para: Shtirja në përzgjedhjen e fjalëve, sforcimi për rimën dhe për temat që u përshtaten nivelit të tyre, duke lënë mënjanë shumicën dërrmuese të njerëzve të thjeshtë dhe të tjerëve si ata.

E dyta: Privimi i popullatës së thjeshtë nga këshillat dhe nga trajtimi i çështjeve shoqërore që janë të dobishme për ta; sepse tashmë ti je angazhuar me temat që u interesojnë intelektualëve dhe nivelit të tyre, të cilët dëshirojnë të dëgjojnë të flitet për hollësitë shkencore, për të rejat më të fundit dhe për kuriozitetet, ndërsa disa prej tyre dëshirojnë të dëgjojnë të flitet për politikën dhe për çështjet e thella aktuale, gjë e cila nuk u sjell asnjë dobi atyre, as në fe e as në jetën e kësaj bote.

E treta: Prishja e nijetit, i cili në vend që të jetë i singertë për hir të Allahut, i kushtohet interesit të dashamirëve tuaj dhe të temave që i mahnisin dhe i kënaqin ata.

Kështu, kur sheh admirimin e njerëzve për hutbet e tua dhe garimin e tyre për të qenë të pranishëm e për t'i dëgjuar ato, nuk ka dyshim se do t'i marrësh ata parasysh dhe do të mbash atë temë që i kënaq ata.

E atëherë, Allahu i Lartësuar të ta rrëmbejë bereqetin, pranimin, mirësinë dhe dobinë.

Kujdesi i ligjëruesit për të mirën e njerëzve të thjeshtë nuk do të thotë që ai të mos trajtojë çështje të rëndësishme, të cilat mund të jenë mbi nivelin e shumicës së tyre, prej të cilave përfiton një kategori e veçantë, si nxënësit e dijes, njerëzit me poste etj. Megjithatë, kjo bëhet sipas nevojës.

3- Ruaje veten nga vetëpëlqimi ose nga lavdërimi i njerëzve!¹

Kur ligjëruesi i xhumasë ngjitet në minber dhe sheh turmat e njerëzve që e kanë synuar dhe kanë ardhur tek ai, e mes tyre sheh dijetarin, mjekun, plakun, gjykatësin, të pasurin dhe zyrtarin, atë mund ta kaplojë vetëpëlqimi, sidomos nëse e di se shumë prej tyre kanë ardhur për hir të tij. Prandaj, është e domosdoshme për ligjëruesin e mençur që t'i kërkojë mbrojtje Allahut nga vetëpëlqimi dhe mendjemadhësia, të luftojë me veten e tij çdo xhuma për t'u çliruar nga vetëpëlqimi dhe lartësimi i vetes, dhe që mirësinë t'ia atribuojë Allahut të Lartësuar, i Cili i solli njerëzit tek ai.

Disa dijetarë të brezave të parë kanë thënë: "Nëse i mban ligjërata dhe këshilla njerëzve, bëhu këshillues për zemrën dhe veten tënde, dhe mos të të mashtrojë tubimi i tyre rreth teje; sepse ata

¹ - Transmetoi Muslimi nr. 2642.

vëzhgojnë anën tënde të jashtme, ndërsa Allahu vëzhgon anën tënde të brendshme!" (9)¹

Prandaj, bëhu i singertë me Allahun e Lartmadhëruar dhe forcoje besimin tënd, dhe bëj kujdes nga mahnitja prej lavdërimit të njerëzve, sepse shumë prej tyre, kur lavdërojnë, e teprojnë, ndërsa ti e njeh veten tënde më mirë!

Ibn Xheuziu, -Allahu e mëshiroftë!-, ka thënë: "Sprova më e madhe janë lavdërimet e njerëzve të rëndomtë, eh sa shumë njerëz janë mashtruar prej tyre!" (10)²

Nuk është e metë që të gëzohesh me lëvdatat e njerëzve për ty ose për ligjëratat e tua, pasi që të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të!) iu tha: "Ç'mendon për njeriun që bën një vepër të mirë dhe njerëzit e lëvdojnë për të?" Ai tha:

«تِلْكَ عَاجِلٌ بِشَرِّ الْمُؤْمِنِ» ([11]).

"Ky është lajmi i mirë i hershëm i besimtarit" (11)³

Kur besimtari e bën një punë singerisht për Allahun, e më pas Allahu i frymëzon besimtarët që ta lavdërojnë, dhe ai i gëzohet mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij, dhe lumturohet me këtë, kjo nuk e dëmton. (12)⁴

Faj dhe mëkat është kur të kaplon vetëpëlqimi nga lëvdatat e tyre, e ti gëzohesh me mundin dhe

1 - "Xhami el-Ulum uel Hikem" i Ibën Rexhebit: 1/ 84.

2 - Transmetoi Muslimi nr. 869.

3 - "Usulul-Insha uel-Hatabe", i Ibn Ashurit: (fq. 126).

4 - "El-Hatabetu 'inde el-'Arab", i Muhamed El-Hidr Husejn: 189.

punën tënde duke ia atribuuar meritën vetes dhe ndërkohë gëzimi yt nuk është për mirësinë, mëshirën dhe bujarinë e Allahut, i Cili ta solli të mirën, ta bëri të dashur dhe ta lehtësoi ty atë.

Shenja që ti vuan nga vetëpëlqimi është se ti e urren kritikën dhe këshillën e dashamirëve.

4- Fliti njerëzve për temat që u sjellin dobi atyre në çështjet e fesë dhe dunjasë!¹

Bëj që ata që kanë ardhur të të dëgjojnë të marrin prej teje këshilla që u sjellin dobi në fenë dhe dunjanë e tyre, dhe pyete veten gjatë përgatitjes: “Çfarë dobie do t’u sjell njerëzve në fenë dhe moralin e tyre kur të dalin nga xhamia?”

E ato gjëra që nuk janë të dobishme për ta mos i përmend!

Pyete veten: çfarë dobie do të kishin sikur të flisja, bie fjala, për çështje të hollësishme të politikës apo të flisja shpesh për fatkeqësitë e muslimanëve?

E çfarë dobie do të kenë ata nga trajtimi i një teme që unë e lë qëllimisht të paqartë, për shkak të ndjeshmërisë së saj dhe frikës sime për ta shprehur haptazi, e kështu flas me nënkuptime dhe aludime që nuk i kupton askush, përveç njerëzve më të veçantë?

¹ - Transmetuan Buhariu nr. 3568 dhe Muslimi nr. 2493.

Dhe çfarë dobie do të kenë kur unë e këshilloj prijësin para njerëzve, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ndërkohë që këshillimin e prijësit publikisht e kanë ndaluar dijetarët e brezave të mirë; sepse kjo shpeshherë shkakton trazira dhe i sjell dëm ligjëruesit.

5- Bëj çmos të ruash qetësinë gjatë hutbes!¹

Duhet të jesh i qetë gjatë hutbes dhe të mos lejosh që entuziazmi të të rrëmbejë e të dalësh nga tema, ose të thuash fjalë për të cilat mund të pendohesh më vonë. Kur ligjëruesit i shtohet entuziazmi, ai zakonisht e humbet përqendrimin dhe kontrollin mbi fjalët e tij dhe ndoshta e ngre zërin deri në atë masë sa të shqetësojë shumë prej dëgjuesve.

6- Ki kujdes nga zgjatja e hutbes!²

Profeti (paqja qoftë mbi të!) e shkurtonte hutben, po ashtu vepruan edhe shokët e tij (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) dhe dijetarët e brezave të mirë të Umetit (Allahu i mëshiroftë!).

Ebu Uaili (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Amari (Allahu qoftë i kënaqur me të!) na mbajti një ligjëratë të shkurtër dhe elokuente. Kur zbriti, ne i thamë: "O Ebu Jekdhan, ligjërata jote ishte vërtet elokuente dhe e përmbledhur, sikur të kishe marrë

¹ - "Zadul-Mead fi Hedji Hajril-Ibad" (1/409-410).

² - Burimi i mëparshëm, 1,386.

frymë?" Ai tha: 'Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja qoftë mbi të!) duke thënë:

«إِنَّ طَوْلَ صَلَاةِ الرَّجُلِ، وَقِصَرَ خُطْبَتِهِ، مِثْلُهُ مِنْ فَقْهِهِ، فَأَطِيلُوا الصَّلَاةَ وَأَقْصِرُوا الْخُطْبَةَ، وَإِنْ مِنَ الْبَيَانِ سِحْرًا» ([13]).

'Vërtet, zgjatja e namazit dhe shkurtimi i hutbes është shenjë e mençurisë së njeriut. Andaj, zgjateni namazin dhe shkurtojeni hutben, dhe vërtet, një pjesë e elokuencës është magji!" (13)

Fjala e tij: (të kishe marrë frymë): D.m.th. sikur ta kishe zgjatur hutben.

Fjala e tij: (shenjë), domethënë provë dhe argument. (e mençurisë së njeriut): domethënë, prej gjërave që tregojnë për mençurinë e njeriut, dhe çdo gjë që tregon për diçka është shenjë e saj.

Shkurtimi i hutbes ka tri dobi të vyera:

E para: pasimi i Sunetit.

E dyta: Lehtësia e përgatitjes së hutbes dhe qetësia shpirtërore gjatë përgatitjes, mbajtjes dhe pas përfundimit të saj.

Shumë ligjërues brengoseshin nga hutbeja, që nga agimi i ditës së premte ose edhe më herët, dhe preokupoheshin mendërisht në përgatitjen e saj. Mirëpo, kur e shkurtuan hutben dhe nuk i kaluan dhjetë minuta në mbajtjen e saj, u largua e gjithë brenga ose pjesa më e madhe e saj.

E treta: Lehtësimi për dëgjuesit, pasi pothuajse të gjithë njerëzit ndjehen mirë me atë që e shkurton hutben dhe nuk e pëlqejnë atë që e zgjat.

Kohëzgjatja e përshtatshme e hutbes për ligjëruesin dhe për dëgjuesit është përafërsisht nga dhjetë minuta deri në një çerek ore; sepse njerëzit pothuajse pajtohen se shkurtimi i hutbes është më i pëlqyeshëm dhe më i lehtë për ta sesa zgjatja e saj.

7- Mos përdor fjalë të panjohura!

Mos përdor fjalë të panjohura dhe të rralla sepse njerëzit nuk kanë nevojë për fjalë të tilla dhe as nuk përfitojnë ndonjë gjë prej tyre, e mundet që egoja të ketë pjesën e vet të kënaqësisë në përdorimin e tepërt të tyre.

Letrarët dhe oratorët e mirëfilltë kanë tërhequr vërejtjen kundër përdorimit të fjalëve të panjohura.

8- Evito rimën e shtirur!

Rima: është "Përputhje e plotë e rrokjeve të fundit të fjalëve në prozë". Ligjvënësi i Urtë e ka ndaluar rimën e shtirur, letrarët dhe oratorët po ashtu nuk e kanë pëlqyer; sepse rima nuk i shpëton shtirjes dhe sforcimit dhe përdorimit të fjalëve të paqarta për dëgjuesin. E nëse lejohet ndonjë formë e rimës, ajo është vetëm ajo që vjen spontanisht, pa sforcim, d.m.th. rima që i vjen vetë ligjëruesit dhe jo ajo që ligjëruesi e synon. (14)

Prandaj, hiq dorë nga rima e shtirur, sepse ajo të mundon për ta formuluar dhe i mundon dhe dëgjuesit për ta kuptuar. Por, nëse ajo të vjen natyrshëm, me fjalë që janë të lehta për gjuhën

tënde dhe të kuptueshme për dëgjuesin, atëherë kjo nuk ka asgjë të keqe.

9- Kujdesu për pamjen!

Kujdesi i ligjëruesit për mirëmbajtjen e pamjes së tij të jashtme nuk duhet të jetë më i vogël se kujdesi për brendësinë e tij, pasi mirëmbajtja apo neglizhimi i anës së jashtme nuk është gjë tjetër veçse pasojë e mirëmbajtjes ose neglizhimit të anës së brendshme. Mirëmbajtja e pamjes së ligjëruesit arrihet si më poshtë:

E para: Bukuria dhe pastërtia e veshjes, pa teprim apo ekstravagancë.

E dyta: Hijeshia e trupit duke e mbajtur pastër, parfumosur, rruajtur ose shkurtuar mustaqet dhe lëshuar mjekrën.

E treta: Hijeshia e fytyrës së tij, me ngazëllimin dhe buzëqeshjen e tij kur i përshëndet njerëzit jashtë xhamisë, kur hyn për të mbajtur hutben dhe pas përfundimit të saj. Sepse buzëqeshja e sinqertë, fytyra e çelur dhe ngazëllimi i bëjnë njerëzit ta duan ligjëruesin dhe të duan hutbet dhe këshillat e tij. Ato janë adhurim për atë që i bën me sinqeritet për Allahun dhe pikërisht ato i pushtojnë mendjet dhe zemrat. Veprat e njeriut me fytyrë të çelur janë të lavdëruara dhe lapsuset e tij janë të pranueshme, ndryshe nga ai që është i vrenjtur dhe i ngrysur, prej të cilit njerëzit ruhen, dhe takimi me të krijon brengosje dhe mungesë rehatie.

Andaj, vëllai im ligjërues, ji me fytyrë të qeshur dhe do të shohësh që do të ndjehesh i qetë dhe njerëzit do të të afrohen, do të përmendin për mirë, do të pranojnë këshillat e porositë e tua dhe do të gjejnë arsye për gabimet dhe lapsuset e tua.

E katërta: Përrulësia dhe edukata gjatë ecjes, ngjitjes në minber dhe uljes në të, si dhe kthimi me fytyrë nga njerëzit në mënyrë të hijshme gjatë qëndrimit ulur dhe ligjëratës.

Një detaj që duhet tërhequr vërejtja ndaj tij është se disa ligjërues, kur ulen para hutbes, marrin një qëndrim që tregon mospërfillje ndaj njerëzve dhe rrinë duke vështruar fytyrat e tyre. Kur fillojnë hutben, i shikojnë njerëzit me vështirime që shprehin mospërfillje dhe indiferencë ndaj tyre, thua se duan t'u tregojnë se janë trima e guximtarë. U drejtohen me një ton të ashpër dhe me zë të ngritur, duke u dhënë urdhra e ndalesa të drejtpërdrejta. Ky stil është i papranueshëm nga shpirtrat e njerëzve, përkundrazi, ata ndiejnë neveri prej këtij njeriu.

E pesta: Të mos e fshijë apo prejë mjekrën pa nevojë dhe të mos kthejë shpesh kokën anash, sidomos gjatë qëndrimit ulur në minber; sepse kjo gjë ia pakëson autoritetin ligjëruesit, ose lë të kuptohet se nuk i kushton rëndësi atyre që ka përballë.

Së gjashti: Përdorimi i misvakut me kujdes dhe edukatë. Disa ligjërues – Allahu i udhëzoftë! – kur

hyjnë në xhami, hyjnë duke përdorur misvakun në një mënyrë që bie në sy. Disa prej tyre vazhdojnë ta përdorin misvakun deri pak para fillimit të hutbes, dhe kështu disa copëza të misvakut i mbesin në gojë, e pastaj i nxjerr ato teksa po ligjëron. Kjo është një vepër e shëmtuar dhe mund të lërë përshtypjen e mospërfilljes së tij ndaj njerëzve dhe ndaj pozitës madhështore të hutbes.

E shtata: T'i përmbahet Sunetit në veshje, duke shmangur lëshimin e rrobave poshtë kyçeve, dhe në mjekër, duke e lëshuar atë; sepse hatibi është shembull. E si mund ta pasojnë njerëzit atë njeri, vepra e të cilit kundërshton fjalën e tij, dhe si mund të ndikohen njerëzit nga fjala e atij njeriu, fjala e të cilit nuk ka ndikuar te vetja e tij?

E teta: Qetësia e gjymtyrëve të trupit gjatë të folurit; sepse kjo është tregues i qetësisë së shpirtit.

10-Variacioni i kohës së përgatitjes së hutbes:

Koha e përgatitjes së hutbes ndryshon sipas kulturës dhe dijes së ligjëruesit (hatibit), dhe sipas materialit që do të ligjërojë, pasi materiali ndahet në dy lloje:

E para: Të jetë me përmbajtje shkencore, siç janë çështjet e fikhut apo të akides dhe trajtimi akademik i tyre, në këtë rast duhet t'i kushtohet koha e merituar dhe nuk duhet të nënvlerësohet duke u përgatitur vetëm pak orë para hutbes.

E dyta: Të jetë këshilluese, shoqërore etj, në këtë rast koha e përgatitjes së saj zakonisht është e shkurtër.

Këshilla ime për ligjëruesin fillestar – atë që nuk zotëron përvojën dhe dijen e mjaftueshme – është që në fillim të përfitojë nga hutbet e ligjëruesve të mëparshëm, në veçanti hutbet e atyre që karakterizohen nga këto tri cilësi:

E para: Të jetë e shkurtër, në mënyrë që mbajtja e saj të mos i bëhet e vështirë.

E dyta: Të jetë e saktë gramatikisht dhe shkencërisht.

E treta: Të mos jetë e ndërlikuar, si në leksik ashtu edhe në përmbajtje.

Me kalimin e kohës, nuk ka asgjë të keqe që ai të ndryshojë apo të shtojë diçka që i duket e përshtatshme, e më vonë të përpiqet ta shkruajë vetë hutben, duke përfituar prej ligjëruesve të vjetër.

11-Shmangia e urdhrave të drejtpërdrejtë ndaj dëgjuesve:

Shmangi – Allahu të ruajtë dhe të udhëzoftë – shprehjet që përmbajnë urdhra vetëm për dëgjuesit e jo për folësin, si: “bëni kështu!” ose “mos bëni kështu!”, dhe në vend të tyre përdor: “le ta bëjmë këtë”, “le ta lëmë këtë” etj. Kjo formë i jep dëgjuesve të kuptojnë se ti je modest, se ua do të mirën atyre

ashtu siç ia do vetes, dhe se ti nuk je mbi ta as në fe e as në moral.

Ligjëruesi i suksesshëm ia drejton fjalën e tij vetes para se t'ua drejtojë të tjerëve dhe e këshillon veten para se të këshillojë të tjerët. Kështu, fjala e tij në hutbe i drejtohet fillimisht atij vetë, para se t'u drejtohet njerëzve. Nëse ai vepron kështu, Allahu e lartëson, i jep dobi nga ajo që thotë dhe ia shton udhëzimin, vlerësimin dhe sinjeritetin.

12-Kur është i lavdërueshëm dhe kur nuk është i lavdërueshëm imitimi në ligjërime?

Mos imito një ligjërues të caktuar në stilin apo përmbajtjen e hutbes së tij, sepse atij mund t'i përshtatet ajo që nuk të përshtatet ty. Imitimi ta dëmton krijimtarinë dhe talentin, prandaj ligjëro sipas aftësive, talentit dhe dijes që të ka dhënë Zoti yt.

Sa i përket fillestarit, nuk ka asgjë të keqe që të përfitojë nga dikush tjetër në stil dhe material, por nuk duhet të jetë një kopje e tij, përkundrazi, duhet ta shfrytëzojë si ndihmë për t'u lartësuar vetë.

13-Mos u pikëllo nëse pjesëmarrësit janë pak e as mos u mburr nëse janë shumë!

Dije, Allahu të bëftë të dobishëm!, se egoja e njeriut lakmon të ketë numër të madh pjesëmarrësish, sidomos prej të afërmeve dhe miqve. Ndoshta ti edhe pyet për praninë e tyre, ose

i qorton – qoftë edhe në zemrën tënde – për mungesën e ndonjërit prej tyre. Prandaj, luftoje veten tënde që të çlirohesh nga kjo sëmundje, sepse mungesa e tij nuk do të thotë se je i dobët, por sepse ai gjen qetësi shpirtërore dhe dobi tek ligjëruesi tjetër, ose për shkak të afërsisë me shtëpinë e tij, apo për arsye të tjera.

Ligjëruesi i singertë gëzohet kur dëgjon se njerëzit marrin pjesë tek dikush tjetër, i lutet Allahut për suksesin dhe dobinë e tij dhe e lavdëron kur mëson diçka të mirë për të.

E nëse vëren pakësimin e të pranishmëve tek ti dhe largimin e njerëzve prej teje, atëherë analizoje veten tënde, sepse e meta mund të jetë tek ti: ose për shkak të stilit të dobët, ose për shkak të materialit të dobët që parashtron, ose për shkak të zgjatjes së hutbes, ose për shkak të sinqeritetit të dobët, apo për shkaqe të tjera.

Kërko këshilla prej vëllezërve të singertë e dashamirës, kërkoju atyre të jenë të pranishëm ose ta dëgjojnë hutben tënde dhe kërkoju me sinqeritet që të të japin vërejtjet dhe mendimet e tyre; kështu, me lejen e Allahut të Lartësuar, do të arrish rezultate të dobishme.

14- Rëndësia e përgatitjes së mirë:

Nëse je nga ata që e improvizojnë hutben: duhet të tregosh kujdes për përgatitjen e mirë të saj dhe mos u trego kurrë neglizhent në këtë aspekt, edhe

nëse tema të duket e thjeshtë dhe e lehtë, dhe e ke trajtuar më parë.

Përgatitja e mirë është një nga çështjet më të këndshme për hatibët; madje, ata e presin me padurim ditën e xhumasë për të paraqitur materialin që e kanë përgatitur dhe për të cilin janë munduar.

Ndërkaq, vazhdimësia në mospërgatitje dhe mjaftimi me ligjëratat e të tjerëve, ka shumë mangësi, si:

E para: Ajo shkakton vullnet të dobët, vendosmëri të lëkundur dhe poshtërim të vetes, pasi në këtë rast ti mjaftohesh me imitimin e të tjerëve.

E dyta: Të humbet entuziazmi, hovi dhe kënaqësia, e kështu ajo shndërrohet në një brengë që do ta largosh prej vetes. Gjë e cila ndikon në sjelljen tënde dhe në pranimin tënd nga njerëzit.

E treta: Shumë njerëz e ndiejnë se ligjëruesi nuk e ka përgatitur vetë hutben, por e ka marrë nga dikush tjetër, dhe kjo për shkak se stili dhe përmbajtja e hutbes ndryshon nga stili dhe niveli i tij, kështu ajo nuk vlerësohet nga ata.

E katërta: Nuk do të përfitosh prej saj, e edhe nëse përfiton, ai është një përfitim i papërfillshëm, sepse puna për të cilën nuk jepet mund në hulumtim dhe përgatitje, harrohet dhe shuhet shpejt.

Dhe nuk do të përparosh, as nuk do të të rritet ambicia, as nuk do të të lartësohet aspirata, dhe as nuk do të përfitohet prej diturisë sate, përveç nëse do Allahu i Lartësuar.

Andaj, po ta shohësh një hutbe të cilën e ke përgatitur mirë, do të vësh se nuk e ke harruar; madje edhe po t'i ktheheshe pas shumë vitesh, do ta dije përmbajtjen e saj, sikurse ta kishe ligjëruar së fundmi.

Ndërsa hutbet që i ke marrë nga të tjerët, i harron shpejt. Bëje provë këtë gjë: ktheju hutbeve të katër apo pesë viteve më parë dhe do të shohësh se i ke harruar, ose mezi i kujton pjesërisht.

Gjithashtu, nuk do të përfitosh prej saj që ta mbledhësh materialin e saj dhe të botosh një libër prej të cilit mund të përfitojnë të tjerët.

Andaj përkushtohu në përgatitjen e hutbes sikur do ta botosh si libër. Bëj verifikimin e burimeve të haditheve dhe sqaro shkallën e saktësisë së tyre, duke u mbështetur në fjalët e dijetarëve të hadithit (muhadithëve). Dokumento referencat dhe burimet të cilave u je referuar dhe kushtoji kujdes të veçantë anës gramatikore, drejtshkrimore dhe gjuhësore.

15-Trego kujdes ndaj shenjave të pikësimit!

Kushtoji vëmendje – nëse e lexon hutben – shenjave të ndalimit dhe pikësimit, si presjeve etj, dhe vendos për vete shenja të veçanta ku të

ndalesh, duke marrë parasysh frymëmarrjen tënde, në mënyrë që të mos vihesh në siklet nga ndaljet e shpeshta në vende të papërshtatshme.

16-Rëndësia e shumëllojshmërisë së temave dhe stileve:

Trajto tema të larmishme dhe mos u kufizo në një stil të vetëm; të mos jenë hutbet e tua vetëm rreth gjendjeve të zemrave, ose çështjeve të përgjithshme të umetit etj, por merri parasysh nevojat e njerëzve në fenë dhe dunjanë e tyre.

Ji sa më i larmishëm, që të ngjallësh në shpirtat e njerëzve mallin për hutbet e tua.

E nëse i bën temat e hutbeve të lidhura me njëra-tjetrën si një zinxhir, nuk ka asgjë të keqe nëse del nga kjo metodë nganjëherë, në rast nevojë.

Dhe dije se tregimet e marra nga Kurani, Suneti i saktë dhe thëniet e sahabëve fisnikë – Allahu qoftë i kënaqur me ta! – kanë ndikim më të madh tek dëgjuesit dhe se në to gjenden mësimet dhe këshilla madhështore dhe udhëzime e margaritarë. Prandaj, trego zell në citimin e tyre dhe paraqitjen me një stil motivues, dhe nxirr prej tyre dobi dhe mësimet.

Mos e bëj hutben tënde të zbrazët nga ngjarjet, tregimet, shembujt aktualë etj; që hutbet e tua të mos jenë të mërzitshme dhe të bajatshme.

Kushtoji kujdesin më të madh stilit më të përsosur në parashtrimin e tregimeve dhe situatave; të bashkëveprosh me to me shpirtin tënd

dhe të pasqyrohet kjo në shprehjen e fytyrës dhe në intonacionin e zërit tënd.

Përpiqu të jetosh realitetin dhe brengat e njerëzve, që të mos jesh ti në një botë e ata në një tjetër.

17-Rëndësia e përvetësimit të aftësive dhe artit të ligjërimit dhe ndikimit:

Ligjëruesi është ai që më së shumti i duhet të përvetësojë aftësinë dhe artin e ligjërimit, sepse ai ka nevojë t'i bindë njerëzit dhe t'ua tërheqë vëmendjen, në mënyrë që ata ta pranojnë atë që ai ua thotë.

Ligjëruesi me stil të fuqishëm dhe oratori të shkëlqyer, zakonisht, u sjell më shumë dobi njerëzve sesa ai që nuk i ka këto tipare, edhe nëse ky i fundit është më i ditur dhe ka pozitë më të lartë.

Ligjëruesi (hatibi) duhet të dëgjojë leksione për artin e ligjërimit, dhe nëse merr pjesë personalisht në to, kjo është edhe më mirë, ose të lexojë librat që e trajtojnë këtë fushë.

Kushdo që është i singertë me Allahun dhe ia kushton Atij veten dhe kohën e vet, Allahu i dhuron nga mirësia dhe dhuntia e Tij atë që as nuk e ka llogaritur e as që i ka shkuar ndërmend. Kush i dhuron Allahut atë që Ai do, Allahu i dhuron atij më shumë se ç'do ai vetë. Dhe kush ia nënshtron veten Allahut, Allahu ia nënshtron atij krijesat e Veta dhe

i mundëson shkaqet e lumturisë, pozitës së lartë dhe rimëkëmbjes.

Pra, mes teje dhe dhuntive të Zotit të Madhërishëm nuk qëndron gjë tjetër veçse vendosmëria e sinqertë dhe vullneti i fortë për hir të Allahut; braktisja e asaj që ti e do dhe e dëshiron për atë që Allahu e do dhe me të cilën kënaqet; si dhe përpjekja e palodhshme për lartësimin e fesë dhe të sheriatit të Tij, madje edhe nëse kjo do të shkaktonte rënien e pozitës sate tek njerëzit e kësaj bote, të cilët janë dhënë pas epsheve dhe pozitave.

18-Parimi i përtëritjes:

Allahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun me prirje për përtëritje dhe ndryshim për më mirë. Për këtë arsye, njerëzit nuk qëndrojnë në një gjendje të vetme dhe, sa herë që në jetë shfaqet diçka e re, nxitojnë ta bëjnë për vete, nëse kanë mundësi.

Njeriu sot nuk është si para dhjetë vitesh, porse ka përtëritje dhe ndryshuar për më mirë në aspektet e jetës, jetesës, mjeteve dhe banesave.

Ligjëruesi i xhumasë është prej njerëzve që më së shumti duhet ta përtërijë dhe ta përmirësojë stilin e tij, t'i zhvillojë aftësitë e oratorisë dhe ndikimit. Sepse, nëse ai vazhdon sipas një modeli të vetëm me të cilin është mësuar qëkurse ka marrë përsipër ligjërimin, atëherë pa dyshim nuk do të ndryshojë për më mirë, por do të ketë regres. Kjo sepse është në natyrën e njeriut që me kalimin e

moshës dhe plakjen t'i dobësohet vullneti dhe t'i bien energjitë, t'i fishket shpirti dhe t'i zvogëlohet ndikimi. Prandaj, ai ka nevojë për diçka që e gjallëron, që ia forcon vullnetin dhe shpirtin, dhe që ia zhvillon aftësitë e stilet e tij, në mënyrë që ta mposhtë gjendjen e dobësisë që e kaplon atë, shqisat dhe vullnetin e tij.

Shumica e ligjëruesve nuk kanë ndryshuar dukshëm qëkurse kanë filluar të ligjërojnë; a do të thotë kjo se ata e kishin arritur përsosmërinë qysh në fillim?

Jo!

Atëherë, përse ai vazhdon me metodën e tij të zakonshme, pa u përkujdesur për stilin dhe ligjërimin e tij dhe pa i ndërmarrë hapat e duhur për përmirësim, rinovim dhe inovacion, ndërkohë që është përpjekur pareshtur t'i përmirësojë çështjet e tij jetësore dhe të kësaj bote?

E si të mos synojë për këtë, kur hutbja është ndër postet më fisnike dhe më madhështore që ai mban në jetën e tij?

19-Kujdesu për dy mjetet e ndikimit: zërin dhe shikimin!

Ligjëruesi (hatibi) i suksesshëm ka nevojë të domosdoshme për përdorimin e këtyre dy mjeteve:

1- Zërin, i cili është mjeti më i fuqishëm i ndikimit; ndikimi i tij plotësohet duke pasur parasysh kriteret e mëposhtme:

a- Të jetë niveli i zërit mesatar në volum dhe në ritëm, pra të mos jetë i ulët apo i ngadaltë që të mos shkaktojë mërzi e plogështi te dëgjuesit, e as të jetë i lartë apo i shpejtë deri në atë masë sa t'i bezdisë apo t'ua bëjë të pamundur përqendrimin dhe përceptimin.

b- Të mos jetë me një intonacion të vetëm, sepse zëri i disa ligjëruesve është i njëjtë gjatë gjithë hutbes: nëse është i dobët, u shkakton mërzi, e nëse është i fortë dhe i lartë, i shqetëson.

Të folurit monoton bën që dëgjuesit të mos ndërveprojnë me fjalët e ligjëruesit, sepse ata nuk do të mund t'i dallojnë pjesët e rëndësishme nga të tjerat. Padyshim që fjalët e rëndësishme dhe me ndikim kërkojnë që zëri të ngrihet dukshëm dhe ritmi të shpejtohet, ose që zëri të ulet dhe ritmi të ngadalësohet.

c-Modulimi i zërit sipas llojit të fjalisë: nëse është pyetje, shqiptoje me ton pyetës, e nëse është habi, shqiptoje me ton habitës, e kështu me radhë.

d- Hape gojën më shumë se në të folurin tënd të zakonshëm, sepse kjo ndihmon në qartësinë e shqiptimit të shkronjave, në mosngatërrimin e tyre dhe në aftësinë për të kontrolluar zërin. Megjithatë, kjo duhet bërë pa e tepruar, pasi teprimi në hapjen e gojës çon në një entuziazëm të tepruar dhe në një pamje jo të hijshme për hatibin.

h- Ligjërojë me zërin tënd të zakonshëm dhe mos i cakto hutbes një zë dhe stil të veçantë, sepse kjo

gjë krijon një hendek mes teje dhe njerëzve dhe bëhet shkak për humbjen e mjeteve më të fuqishme të ndikimit të dëgjuesit.

Bëj pauza të shkurtra në rastet kur një gjë e tillë është e nevojshme; nëse ligjëruesi trajton një ide të rëndësishme, të cilën dëshiron ta ngulisë në mendjet e dëgjuesve: të kthehet nga ata, t'i shikojë drejtpërdrejt në sy për një çast, pa thënë asgjë.

Kjo heshtje e papritur ka ndikim të madh tek ata; u tërheq vëmendjen dhe bën që secili prej tyre të jetë i vëmendshëm dhe kureshtar për atë që do të pasojë.

Mirëpo, pauza nuk duhet të jetë e gjatë dhe e tepruar.

Shembull për këtë është rasti kur Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i dërgoi Profetit (paqja qoftë mbi të!) një copë ari, e ai e ndau atë mes disa prej shokëve të tij.

Një njeri u afrua dhe i tha: "Frikësoju Allahut, o i Dërguari i Allahut!" (...)

Çfarë guximi i madh kundër të Sinqertit e Besnikut (paqja qoftë mbi të)!

Prandaj, i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të!) tha, i habitur nga ky guxim: (...) "Kush i bindet Allahut, nëse unë e kundërshtoj Atë? Allahu më beson mua për banorët e Tokës, e ndërsa ju nuk më besoni?!"

Pikat ndërmjet kllapave tregojnë një pauzë të shkurtër; kjo bëhet sepse rasti e kërkon, që t'u

tërhiqet vëmendja dhe t'u zgjohet kureshtja dëgjuesve për atë që do të thuhet më pas.

Fjala e parë: (Çfarë guximi i madh ndaj të Singertit, Besnikut! (paqja qoftë mbi të!), është një mënyrë për të shprehur habinë, prandaj konteksti e kërkonte që të formulohej në formë habitore.

Ndërsa fjalia e dytë: (Kush i bindet Allahut, nëse unë e kundërshtoj Atë? Vallë, a më ka besuar Allahu mua mbi banorët e tokës, e ju nuk më besoni?), është në stilin e një pyetjeje qortuese, andaj edhe konteksti kërkon që ajo të formulohet në formën e pyetjes qortuese.

2- Shikimi: Hedhja e shikimit te të gjithë dëgjuesit dhe ndërveprimi me sy me ata përmes asaj që je duke thënë. Kjo arrihet duke:

a- U kthyer pak djathtas e majtas, as shpesh e as shumë, sepse ky veprim nuk pëlqehet nga ligjëruesi në veçanti; ngase kjo tregon se emocionet e tij e mbizotërojnë dhe e kontrollojnë atë, gjë që çon në mungesë përqendrimi.

b- Duke i hapur sytë ose duke i mbyllur lehtë; sepse lëvizjet e syrit kanë ndikim të madh tek të pranishmit, ata arrijnë të kuptojnë nga sytë atë që nuk e kuptojnë nganjëherë nga gjuha.

Zëri dhe shikimi janë dy shtylla themelore të ndikimit të ligjëruesit te dëgjuesit. Pa to, ai e humbet aftësinë që t'ua përcjellë mesazhin, t'i bindë, si dhe t'ua tërheqë vëmendjen, dhe të krijojë atmosferë entuziazmi dhe gjallërie.

Secili ligjërues mund t'i përdorë ato të dyja pa vështirësi dhe pa sforcim, por pa e tepruar, sepse teprimi në këtë gjë tregon mendjelehtësi dhe pamaturi, ashtu siç edhe teprimi në seriozitet dhe autoritet shkakton mërzitje dhe monotoni. E më e mira e çështjeve është mesatarja.

Po ashtu, ka disa gjëra që nuk i përshtaten hatibit të xhumasë, si:

1- Lëvizja e duarve.

2- Lëvizja e takijes apo çallmës, ngacmimi i altoparlantëve, lëvizja para-prapa etj.

20- Mos iu përmbaj një shprehje të caktuar që nuk është vërtetuar me Sunet të saktë!

Nuk duhet t'i përmbahemi një shprehje të caktuar, përveç nëse është vërtetuar me Sunet të saktë, në mënyrë që të mos mendohet se është Sunet, siç është shprehja: "Allahu më bekoftë mua dhe juve me Kuranin e Madhërishëm!" në fund të hutbes së parë.

Shpeshherë, disa ligjërues i përmbahen një lutjeje në fund të hutbes, të cilën pothuajse nuk e ndryshojnë, dhe disa prej tyre e zgjasin këtë lutje të përsëritur, saqë shumë njerëz, kur ligjëruesi fillon lutjen, ndiejnë bezdi dhe mërzitje; kjo sepse janë mërzitur nga përsëritja e saj e shpeshtë me një stil ku mbizotëron recitimi mekanik dhe mungesa e ndërveprimit të kërkuar në lutje.

21- Ki kujdes ndaj shqiptimit të shkronjave dhe mos i ngatërro ato!

Kujdesu t'i shqiptosh shkronjat duke i nxjerrë saktë nga vendi i tyre, sepse kjo ka ndikim të madh në rrjedhshmërinë, qartësinë dhe fuqinë e fjalës.

Ndër të metat e ligjëruesit është që të flasë me nxitim, duke i bashkuar shkronjat apo fjalët me njëra-tjetrën, para se e para të jetë shqiptuar plotësisht. Ndërsa etika kërkon që shkronjat të artikulohen plotësisht dhe fjalët të ndahen qartë nga njëra-tjetra.)

E tillë ishte edhe e folura e krijesës më elokuate (paqja qoftë mbi të!).

Nëna e besimtarëve, Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: “Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) nuk i shqiptonte fjalët rrëmbimthi siç i shqiptoni ju.”

22- Cili është qëllimi i hutbes dhe cilat janë temat më të rëndësishme që duhet t'i trajtojë ligjëruesi?

Ligjëruesi duhet t'i zhvendosë njerëzit nga bota e kësaj jete, brengat dhe ngjarjet e saj, në botën e ahiretit dhe përgatitjen për të. Xhamia nuk duhet të jetë një tribunë mediatike, ku ligjëruesi trajton çështje politike dhe thellohet në gjëra që nuk u sjellin dobi dëgjuesve as në fenë dhe as në jetën e tyre të kësaj bote.

Ligjëruesi i suksesshëm, me shumicën e hutbeve synon shtimin e imanit dhe forcimin e lidhjes me Allahun e Madhëruar; sepse, kur njerëzve u shtohet imani dhe u forcohet lidhja me Zotin e tyre, ky është shkaku më i madh që t'i braktisin mëkatet dhe çështjet e kota.

Prej temave që ligjëruesi (hatibi) obligohet të mos i anashkalojë dhe që duhet t'i përsërisë vazhdimisht, janë:

Teuhidi dhe shtyllat e Islamit.

Forma e namazit dhe rëndësia e përkushtimit në të.

Tematika sezonale, siç është të folurit për vlerën e muajit të Ramazanit kur i vjen koha.

Paralajmërimi kundër fitneve (sprovave) dhe mënyra e ballafaqimit me to.

Paralajmërimi nga bidatet.

Paralajmërimi nga kurthi i shejtanit dhe rrugët e mashtrimit të tij.

Morali, etika dhe çështjet që lidhen me to.

Disa nga temat që e shtojnë besimin dhe lidhjen me Zotin janë:

1- Madhërimi i Allahut në shpirtrat e njerëzve, përmes përmendjes së cilësive dhe mirësive të Tij.

2- Madhërimi i Kuranit, që është Fjala e Tij.

3- Përmendja e historive të profetëve (paqja qoftë mbi ta) -me në krye të tyre vulën e profetëve, Profetin tonë Muhamedin (paqja qoftë mbi të!)- dhe të sahabëve fisnikë (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

4- Përmendja e Xhenetit, përshkrimi i tij dhe i shkaqeve që të çojnë në të, po ashtu edhe përmendja e Zjarrit dhe shkaqeve që të fusin në të.

5- Kujdesi për adhurimet shpirtërore, si: mbështetja në Allahun, kthimi me keqardhje tek Ai, pendimi, droja dhe përulja.

Hoxha i madh Ibën Kajimi, -Allahu e mëshiroftë!-, thotë: Kushdo që mediton mbi ligjëratat e Profetit (paqja qoftë mbi të!) dhe të shokëve të tij, do të shohë se ato mjaftojnë për të shpjeguar udhëzimin dhe monoteizmin, për të përmendur cilësitë e Zotit të Madhërishëm, bazat e përgjithshme të besimit dhe thirrjen për tek Allahu. Në to theksohen dhuntitë e Allahut, të cilat e bëjnë Atë të dashur për krijesat e Tij, si dhe ditët e ndëshkimit të Tij, të cilat u kujtojnë atyre rreptësinë e Tij. Në to theksohet urdhri për përmendjen dhe falënderimin e Tij, gjë që i bën ata të dashur për Të. Në to theksohet gjithashtu madhështia, cilësitë dhe emrat e Tij, të cilat bëjnë që ata ta duan Allahun. Në to urdhërohet për bindje, falënderim e përkujtim ndaj Tij, gjë që i bën ata të dashur për Të. Si rrjedhojë, njerëzit largoheshin, duke e dashur Atë dhe Ai i donte ata.

Më pas, pas një kohe të gjatë, drita e profetësisë u zbeh, ndërsa ligjet dhe urdhrat u shndërruan në ceremoni që kryheshin pa marrë parasysh thelbin dhe qëllimet e tyre. E mbajtën formën e tyre të jashtme dhe i stolisën me zbukurime të shumta. Ceremonitë dhe formalitetet i kthyen në tradita që

nuk mund të neglizhoheshin, ndërkohë neglizhuan qëllimet, të cilat nuk duhet të neglizhohen. Hutbet i stolisën me prozë të rimuar dhe me figura retorike, dhe kështu u pakësua – madje u zhduk fare – dobia e zemrave prej tyre, e bashkë me të humbi edhe qëllimi i tyre.

Teksa flet për qëllimin e hutbes, ai (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Me të synohet lavdërimi i Allahut dhe madhërimi i Tij; dëshmia për njëshmërinë e Tij dhe për misionin e të Dërguarit të Tij (paqja qoftë mbi të!); përkujtimi i robërve për ditët e shënuara të Tij; paralajmërimi i tyre ndaj ashpërsisë dhe ndëshkimit të Tij; porositja e tyre për atë që i afron tek Ai dhe xhenetet e Tij dhe ndalimi i tyre nga ajo që i afron drejt zemërimit dhe zjarrit të Tij. Ky pra është qëllimi i hutbes dhe i tubimit për të."

Ligjëruesi (hatibi) duhet t'i ndërgjegjësojë njerëzit për gabimet e përhapura mes tyre në besim, adhurim, moral, marrëdhënie me të tjerët, jetesë, edukim etj, dhe t'i paralajmërojë nga përfshirja në trazira dhe t'ua mësojë çështjet e fesë së tyre.

Allahu është më i Dijshmi. Paqja dhe bekimi qofshin mbi Profetin tonë Muhamedin, familjen dhe gjithë shokët e tij.

Përmbajtja

RËNDËSIA E HUTBES	3
Melekët e Mëshiruesit të dëgjojnë me vëmendje, prandaj jepu pozitën që u takon!	6
Cila është më e mirë: improvizimi i ligjëratës apo leximi i saj nga letra?.....	8
TETË HAPA QË LEHTËSOJNË DHE HAPIN RRUGËN	9
DREJT PERFORMANCËS SË SUKSESSHME NË LIGJËRIM.....	9
ANKTHI DHE TENSIONI NË FILLIM TË MBAJTJES SË HUTBEVE ËSHTË DIÇKA NORMALE DHE E ZAKONSHME ...	12
SHKAQET E KAPËRCIMIT TË FRIKËS SË TEPRUAR NGA TË FOLURIT NË PUBLIK	13
ZGJIDHJA MË E MIRË PËR KRITIKAT E GABUARA QË TË VIJNË	16
POROSI PËR LIGJËRUESIN PARA HUTBES	17
UDHËZIME PËR LIGJËRUESIN GJATË HUTBES.....	21
POROSI PËR HATIBIN PAS HUTBES	22
KËSHILLA TË PËRGJITHSHME PËR LIGJËRUESIN DHE PREDIKUESIN	23
1-Përgëzo dhe mos krijo panik!.....	23
2-Ki në qendër të vëmendjes publikun e gjerë!.....	24
3- Ruaje veten nga vetëpëlqimi ose nga lavdërimi i njerëzve!	26
4- Fliti njerëzve për temat që u sjellin dobi atyre në çështjet e fesë dhe dunjasë!	28
5- Bëj çmos të ruash qetësinë gjatë hutbes!	29
6- Ki kujdes nga zgjatja e hutbes!.....	29
7- Mos përdor fjalë të panjohura!	31
8- Evito rimën e shtirur!.....	31
9- Kujdesu për pamjen!	32

10-Variacioni i kohës së përgatitjes së hutbes:	34
11-Shmangia e urdhrave të drejtpërdrejtë ndaj dëgjuesve:	35
12-Kur është i lavdërueshëm dhe kur nuk është i lavdërueshëm imitimi në ligjërime?	36
13-Mos u pikëllo nëse pjesëmarrësit janë pak e as mos u mburr nëse janë shumë!	36
14- Rëndësia e përgatitjes së mirë:	37
15-Trego kujdes ndaj shenjave të pikësimit!.....	39
16-Rëndësia e shumëllojshmërisë së temave dhe stileve:....	40
17-Rëndësia e përvetësimit të aftësive dhe artit të ligjërimit dhe ndikimit:	41
18-Parimi i përtëritjes:	42
19-Kujdesu për dy mjetet e ndikimit: zërin dhe shikimin!...	43
20- Mos iu përmbaj një shprehje të caktuar që nuk është vërtetuar me Sunet të saktë!	47
21- Ki kujdes ndaj shqiptimit të shkronjave dhe mos i ngatërro ato!	48
22- Cili është qëllimi i hutbes dhe cilat janë temat më të rëndësishme që duhet t'i trajtojë ligjëruesi?	48